



**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°11/2022

Hagë, 24/03/2022

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë, informacion për javën e ardhshme dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Një nga arritjet e tjera domethënëse të DHSK-së, ishte mbyllja e gjykimit të z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj të enjten e shkuar, me deklaratat përmbyllëse të palëve dhe deklaratat e z. Gucati dhe z. Haradinaj. Trupi Gjykses do të nxjerrë aktgjykimin në kohën e duhur në përputhje me kornizën ligjore të DHSK-së.

Në çështjen *Salih Mustafa*, janë mbajtur seanca gjyqësore gjatë gjithë kësaj jave.

Ditën e hënë, mbrojtësja e viktimave i bëri parashtrime gjykatës në emër të viktimave të pranura si pjesëmarrëse në proces dhe një prej viktimave shprehu mendimet dhe shqetësimet e veta para Trupit Gjykses.

Ditën e martë, mbrojtësi i z. Mustafa bëri deklaratën e vet hyrëse në të cilën parashtronte arsyet pse, sipas Mbrojtjes, z. Mustafa duhet të lirohet nga akuzat e ngritura kundër tij.

Ditën e djeshme dhe të sotshme Mbrojtja, në kuadër të paraqitjes së provave të veta, thirri dëshmitarin e parë. Dëshmitarit i drejtoi fillimisht pyetje Mbrojtja dhe më pas Zyra e Prokurorit të Specializuar. Dëshmitarit i bëri pyetje edhe mbrojtësja e viktimave.

Mbrojtja do të vijojë me paraqitjen e provave javën e ardhshme, midis datave 28 dhe 31 mars.

Më 21 mars, Trupi Gjykses nxori vendimin e nëntë të rishikimit të paraburgimit të z. Mustafa dhe urdhëroi vazhdimin e mbajtjes së tij në paraburgim. Gjykatësit

1





**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°11/2022

Hagë, 24/03/2022

konstatuan se asnjë prej kushteve, përfshirë kushtet e propozuara nga Mbrojtja, nuk e ulin mjaftueshëm rrezikun e pengimit prej z. Mustafa të ecurisë së procesit përmes ndërhyrjes ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, dhe/ose familjeve e tyre.

Javën e shkuar, më 18 mars, Trupi Gjykes në çështjen *Mustafa* urdhëroi palët, mbrojtësen e viktimave dhe Administratoren të rishikojnë disa prej transkripteve dhe të dorëzojnë parashtrime nëse mund të hiqen disa nga redaktimet ekzistuese dhe/ose transkriptet të riklasifikohen si publike.

Më 22 mars, Paneli i Gjykatës së Apelit në çështjen z. *Hashim Thaçi dhe të bashkakuzuarit* hodhi poshtë apelet e z. Thaçi dhe z. Veseli kundër vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake të 23 dhjetorit 2021. Në vendimin në fjalë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi pjesërisht leje për ZPS-në që të ndryshojë Aktakuzën në këtë çështje. Vendimin përkatës të Panelit të Gjykatës së Apelit mund ta gjeni në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Seanca vijuese e procedurës paraprake në këtë çështje është planifikuar të mbahet sot pasdite në orën 14:30. Seanca do të transmetohet më 45 minuta vonesë në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara të Kosovës, në të tria gjuhët zyrtare të gjykatës.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

